

VENDIM

NR. 3 DATA 07/12/2022

**IMBLEDHJES SË ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË ORTAKËVE TË SHOQËRISË
“SEA LAND ALTERNATIVE INVESTMENT FUND” SHOQËRI KOMANDITE SIK**

**“MBI MIRATIMIN E RITJES SË KAPITALIT THEMELTAR TË SHOQËRISË
“SEA LAND ALTERNATIVE INVESTMENT FUND” SHOQËRI KOMANDITE
SIK” DHE TRANSFERIMIT TË FONDEVE PËR EFEKT TË RITJES SË
KAPITALIT”**

Sot më datë 07/12/2022 në Mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë “Sea Land Alternative Investment Fund”, Shoqëri Komandite SIK, e cila bazuar në Statutin e Shoqërisë, në ligjin nr.56/2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”, neni 56 e në vijim në ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”(i ndryshuar), bazuar në kompetencat që i jep ligji, si dhe për mbarëvajtjen e zhvillimit të punës,

VENDOSI:

1. Të miratojë rritjen e kapitalit themeltar të Shoqërisë “Sea Land Alternative Investment Fund”, Shoqëri Komandite SIK, nëpërmjet derdhjes së kontributeve të reja në para në vlerën 55,000,000.00 (pesëdhjetë e pesë milion) lekë, përkatësisht:
 - Vlera prej 25,000,000.00 (njëzet e pesë milion) lekë nga ortaku i kufizuar i shoqërisë Z. Renis Tërshana.
 - Vlera prej 30,000,000.00 (tridhjetë milion) lekë nga ortaku i pakufizuar i shoqërisë shoqëria Banka Credins.
2. Me zbatimin si dhe ndjekjen e procedurave të këtij vendimi, ngarkohet Administratori i Shoqërisë “Sea Land Alternative Investment Fund”, Shoqëri Komandite SIK.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Mbledhja e datës 07/12/2022 u mbajt me pjesëmarrjen e:

Për Banka Credins sh.a. zotërues në 99.14 % të kapitalit themeltar:
Z. MALTIN KORKUTI (përfaqësues i autorizuar i Banka CREDINS sh.a.)

Për Z. Renis Tërshana zotërues në 0.86 % të kapitalit themeltar:
Z. Renis Tërshana